

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOFIKA K. BRAKA
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.11, NR.1, NR.1
TEL: 684066835

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 492

Nr. koleksioni: 312

Tirane më 29/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021052850031457261

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DEGA VENDORE TIRANË
Nr. 49 Rep. Nr. 312 Kol.

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Sot me datën 29/04/2021 përpara meje Notere Sofika K. BRAKA, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rr. "Ismail Qemali" Pall. 11/1, Apartamenti 1, Tirane, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm për lidhjen e kësaj kontrate shitblerje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

Shitësi:

- Shoqëria "RDA Petrol" Sh.a., regjistruar si person juridik në datën 29.04.2013, me NUIS: L36629201C, me seli në Tiranë, rruga "Vaso Pasha", pallati 13/1, kati 3/D, e përfaqësuar nga Administratori **z. Fation Veizaj**, i biri i Sulos, i datëlindjes 18.09.1966, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rruga "Brigada e VIII", pallati nr. 5, apartamenti nr. 3, identifikuar me Letërnjoftimin ID nr. 031427149 dhe me numër personal G60918033N, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Blerësi:

- **z. Kujtim Kale**, i biri i Kujtimit, i datëlindjes 08.10.1979, lindur e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin ID nr. 034080311 dhe me numër personal H91008132K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 1

- 1.1 Shitësi është ortak i 100% të kuotave të shoqërisë "Exchange Line" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 08.02.2021, me NUIS: M11408036V, me seli në Tiranë, rruga "Ibrahim Rugova", pallati "Shallvare", nr. 52, Zona Kadastrale nr. 8380, nr. pasurie 7/135, N1.
- 1.2 Këto kuota të kapitalit të shoqërisë "Exchange Line" Sh.p.k., që ai zotëron, i shet me vlerën e tyre nominale Blerësit **Kujtim Kale** në masën 100%, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve të përcaktuara me poshtë në këtë kontratë.



Neni 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së 100% të kuotave të shoqërisë "Exchange Line" Sh.p.k., është me vlerën e tyre nominale prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lekë.
- 2.2 Ky çmim do të likuidohet nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit dhe do të vërtetohet me mandatin bankar përkatës.

Neni 3

- 3.1 Blerësi i blen kuotat që shet shitësi në raportin e mëposhtëm:
z. **Kujtim Kale**, blen dhe behet ortak me 100% (njëqind përqind) të kuotave, të shoqërisë "Exchange Line" Sh.p.k., me vlerë 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lekë.
- 3.2 Me shitjen e këtyre kuotave, që shitësi i shet blerësit nga ato të zotëruara prej tij, blerësi bëhet pronar i këtyre kuotave me të drejta të plota në raportet e mëposhtme:


z. Kujtim Kale - zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar.

Neni 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ia shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë, Blerësit, të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë, të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

Neni 5

- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në



zgjdhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Unë Noterja mora autorizimin për përdorimin e te dhënave personale të palëve dhe të dhënat e përdorura në këtë dokument, të cilat do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin dhe redaktimin e këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe rigoroz të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

Kontrata hartohet në 4 (katër) ekzemplarë, me të njëjtën vlerë ligjore. Unë noterja, pasi iu bëra me dijeni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018, date 20.12.2018, "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

PALET KONTRAKTORE

SHITËSI
Shoqëria "RDA Petrol" Sh.a.
Administratori
Fation VEIZAJ

Fation Veizaj
[Signature]



BLERËSI
Kujtim KALE

Kujtim Kale
[Signature]

NOTERE
Sofika K. BRAKA

